

20120381096

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Në përputhje me nenin 18-a paragrafi 2 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/05, 47/06, 42/07, 86/08, 72/10 dhe 158/11), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

RREGULLOREN PËR NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR QITJET EKSPERIMENTALE, MËNYRËN E REALIZIMIT TË QITJEVE EKSPERIMENTALE DHE RUAJTJEN E FISHEKËVE NGA ARMËT E PËRDORURA PËR QITJET EKSPERIMENTALE

Neni 1

Në Rregulloren që ndryshon Rregulloren për përbërjen e komisioneve të Ministrisë së Punëve të Brendshme për qitjet eksperimentale, mënyrën e realizimit të qitjeve eksperimentale dhe ruajtjen e fishekëve nga armët e përdorura për qitjet eksperimentale (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 94/09 dhe 155/10) në nenin 2 fjala “tetë” fshihet.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Komisionet e përmendura në nenin 2 të kësaj Rregulloreje përbëhen nga punonjësit e Sektorit të Punëve të Brendshme për fushën për të cilën formohet Komisioni në fjalë.

Komisioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përbëhet nga kryetari dhe tre anëtarë:

- kryetari dhe një nga anëtarët janë oficer policie në uniformë;
- një nga anëtarët është nga njësia përkatëse organizative për armët dhe
- një nga anëtarët është nga njësia përkatëse organizative e kriminalistikës

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë pas botimit në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Numër 121-16920/1
15 mars 2012
Shkup

Ministre
e Punëve të Brendshme,
MA Gordana Jankuloska, nënshkrimi